

Data 06.05.2026

**PROCESVERBAL – TIPI KONTRATËS – SHËRBIME**  
**(PROCEDURË E HAPUR, MBI KUFIRIN E LARTË MONETAR)**  
**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE**  
**PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** Menaxhimi i mbetjeve të projektit të gjenerimit termik "Impianti Llundres i Përkohshëm dhe Infrastruktura Ndihmëse".

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):** 98390000-3 - Shërbime të tjera.

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 28,100,000 (Njëzet e tetë milion e njëqind mijë) Lekë, pa TVSH ose 293,994 (Dyqind e nëntëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e nëntëmbëdhjetë e katër) Euro pa TVSH.

**Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 06/05/2026 është 95.58Lekë/Euro.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar autoriteti/enti kontraktor Korporata Elektroenergjitike Shqiptare , KESH sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;

### Argumentimi:

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit" dhe Neni 83 "Sigurimi i ofertës" të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar. Në Nenin 83 të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" citohet: "Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël", Neni 82, i LPP "1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet Kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të

*vetdeklarimet, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.*

## **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: Sa më sipër.**

#### **Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP i ndryshuar, nenit 41, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 2(dy) fishi i vlerës së përllogaritur të fondit limit.

*Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.*

#### **Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, i ndryshuar, si dhe nenin 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në dispozitat e legjislacionit Ligj Nr. 29/2023 PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT (Ndryshuar me aktin normativ nr. 2, datë 7.6.2023; aktin normativ nr. 7, datë 14.12.2023; vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 52, datë 27.6.2024; aktin normativ nr. 4, datë 27.11.2024, ligjin nr. 9/2025, datë 30.1.2025; nr. 81/2025, datë 11.12.2025) (i përditësuar), VENDIM Nr. 211, datë 9.4.2025 PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 922, DATË 29.12.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR DEKLARIMIN E DETYRUESHËM TË DEKLARATAVE TATIMORE DHE TË DOKUMENTEVE TË TJERA TATIMORE, VETËM NËPËRMJET FORMËS ELEKTRONIKE”, UDHËZIM Nr. 24, datë 6.11.2025 PËR DISA SHTESA DHE NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN E PËRGJITHSHËM NR. 26, DATË 8.9.2023, “PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR.

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 39% e fondit limit.

*Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:*

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

### **Argumentimi:**

Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në një vlerë jo më të vogël se 39% e fondit limit, brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Për Autoritetin Kontraktor KESH sh.a, plotësimi i këtij kriteri është i rëndësishëm pasi shërbimet e mëparshme të ngjashme të realizuara në sektorin publik apo sektorin privat janë kushte të nevojshme që garantojnë se Operatorët Ekonomikë mbi bazën e vlerës së shërbimeve të mëparshme të ngjashme vërtetojnë se zotërojnë kapacitete për të zbatuar me sukses këtë procedure prokurimi.

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licensë me kodin VII.5.3 "Për ushtrimin e veprimtarisë së tërheqjes së mbetjeve të ngurta dhe vajore në portet e tjera detare të Republikës së Shqipërisë dhe radat e tyre".

*Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri Operatori Ekonomik duhet të paraqesë licensën me kodin VII.5.3.*

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licensë me kodin III.2.B "Grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme të rrezikshme dhe jo të rrezikshme".

*Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri Operatori Ekonomik duhet të paraqesë licensën me kodin III.2.B.*

### **Argumentimi:**

Kriteret e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, ku pika 4/a citon se :

"Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: **licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore**".

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar Drejtues teknik të shoqërisë i cili të jetë i pajisur me çertifikatë kompetence profesionale të lëshuar nga DPSHTRR.

***Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:***

- ✚ Kontratë pune të vlefshme;

- ✚ Çertifikatë Kompetence profesionale të lëshuar nga DPSHTRR;
- ✚ Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për periudhën Shkurt 2026 – Prill 2026.

### **Argumentimi:**

Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/b, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku pika 4/b citon se :

"Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose". Si dhe bazuar në Ligjin Nr. 118/2012 PËR TRANSPORTIN E MALLRAVE TË RREZIKSHME.

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 2(dy) drejtues mjete, të cilët të jenë të pajisur me çertifikatë të vlefshme kualifikimi i cili duhet të jëtë i lëshuar në përputhje me dispozitat e ADR-së.

*Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaratimit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaratimit si:*

#### **Për drejtuesit e mjeteve të paraqiten:**

- ✚ Kontratë pune të vlefshme;
- ✚ Leje drejtimi automjeti të vlefshme;
- ✚ Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për periudhën Shkurt 2026 – Prill 2026.
- ✚ Çertifikatat e vlefshme të kualifikimit në përputhje me dispozitat e ADR-së. Sipas ligjit Nr.118/2012 “Për transportin e mallrave të rrezikshme”.

### **Argumentimi:**

Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/b, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku pika 4/b citon se :

"Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose". Si dhe bazuar në Ligjin Nr. 118/2012 PËR TRANSPORTIN E MALLRAVE TË RREZIKSHME, Neni 35 Kushtet dhe detyrimet e drejtuesit të mjetit.

**2.3.6** Operatori ekonomik ofertues, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë minimalisht 2 (dy) automjete të përshtatshme për transportin e lëndëve të rrezikshme, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike dhe në legjislacionin në fuqi për transportin e mallrave të rrezikshme të pajisura me certifikatë të vlefshme ADR.

***Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:***

- *Çertifikatë pronësie e mjetit, (në rastin kur mjeti është në pronësi)*
- *Dokument që vërteton regjistrimin e mjetit (Leje qarkullimi),*
- *Çertifikatë të kontrollit teknik të mjetit të vlefshëm,*
- *Siguracion të mjetit të vlefshëm,*
- *Çertifikatë të vlefshme ADR*
- *Në rastin kur mjeti është marrë me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të zbatimit të kontratës.*

#### **Argumentimi:**

Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku pika 4/ç citon se :

*"Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën."*

Si dhe bazuar në Ligjin Nr. 118/2012 PËR TRANSPORTIN E MALLRAVE TË RREZIKSHME nenit 12 Mjetet për transportin e mallrave të rrezikshme, pika 1 gërma “c” ku citohet: 1. Për transportin e mallrave të rrezikshme përdoret mjeti: c) që është i pajisur me panele (pallakata) dhe është i shënuar në përputhje me dispozitat e ADR-së.

Pra sa më sipër cituar furnizuesi ka detyrimin ligjor që për automjetet që do të transportojnë këto mbetje të rrezikshme të jetë i pajisur me çertifikatë të vlefshme ADR.

**Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.**

**Të gjitha dokumentet duhet të paraqiten të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.**

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike:**

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, sipas parashikimeve të nenit 36 të Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

*Specifikimet teknike janë hartuar nga Grupi i punës (sipas procesverbalit pjesë integrale e kësaj procedure) ku në të citohet se:*

Termat e referencës janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, sipas parashikimeve të nenit 36 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

Gjenerimi i energjisë nga impianti termik lundruar i përkohshëm TEC Vlorë dhe infrastruktura ndihmëse, një aktivitet ky i pajisur me Leje Mjedisore, ndër detyrime të tjera ligjore, gjithashtu ka si detyrim menaxhimin e mbetjeve të prodhuara nga ky aktivitet.

Mbetjet e prodhuara janë të llojit:

- “Mbetje të rrezikshme”
- “Mbetje jo të rrezikshme”

Për sa më sipër, si dhe referuar nevojës së lindur për menaxhimin e mbetjeve nga funksionimi i impiantit të lundruarshëm, shoqërisë KESH sh.a i nevojitet të prokurojë shërbimin për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme.

**Njësia e Prokurimit**